



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

**URDHËR**

Nr. 5, datë 19/02/2015

**PËR**

**“MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME BAZË MBI  
PROGRAMIMIN E INSPEKTIMEVE”**

Në zbatim të nenit 16, pika 2, germa c të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin dhe zbatimin e Rregullave të Përgjithshme bazë mbi Programimin e Inspektimeve.
2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

---

Adresa: Rruga: “Frosina Plaku” Nr. 58, Godina e Observatorit Kati 0, Tiranë.  
Tel: 042 229765, Fax: 042 228983  
[www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al)

3. Ky urdhër publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror, [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al), si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM**



# **RREGULLA TË PËRGJITHSHME BAZË MBI PROGRAMIMIN E INSPEKTIMEVE**

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Fusha e zbatimit**

Rregullat e përgjithshme bazë për programimin e inspektimeve, që në vijim do të referohen si rregulla të përgjithshme, janë të zbatueshme nga institucionet qendrore të ngarkuara me një ose disa funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të Ligjit për Inspektimin, që në vijim do të referohen si inspektorate shtetërore.

### **Neni 2 Qëllimi**

Rregullat e përgjithshme kanë për qëllim harmonizimin e metodologjive për programimin e inspektimeve të inspektorateve shtetërore, sipas parimeve dhe standarteve, si dhe bazuar në procedurat e Ligjit për Inspektimin.

## **KREU II PROGRAMIMI I INSPEKTIMEVE**

### **Neni 3 Programi i inspektimeve**

1. Programi i inspektimeve është instrumenti që përdor inspektorati shtetëror për planifikimin e akteve të inspektimit në subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën përkatëse të inspektimit, me qëllim kontrollin për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.
2. Programi i inspektimeve bëhet mbi bazuar mbi kritere objektive dhe të publikuara paraprakisht, si vlerësimi i riskut që prodhojnë subjektet e inspektimit dhe objektivat vjetorë dhe afatmesëm të përcaktuar për inspektoratin shtetëror.
3. Programi i inspektimeve, në varësi të intervalit kohor për të cilin bëhet, përcakton elementë të ndryshëm si vijon:
  - a. Programimi vjetor i inspektimeve bëhet mbi bazë tematike dhe ka për qëllim planifikimin sasior të akteve të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave të inspektimit gjatë vitit;
  - b. Programimi mujor i inspektimeve bëhet mbi bazë subjektsh inspektimi dhe ka për qëllim planifikimin e akteve të inspektimit dhe përcaktimin e subjekteve të inspektimit gjatë muajit;

- c. Programimi javor bëhet mbi bazën e subjekteve të inspektimit të planifikuar për mujin përkatës dhe ka për qëllim planifikimin e akteve të inspektimeve, përcaktimin e inspektorëve shtetërorë, datës dhe orës, kohëzgjatjes dhe objektit e inspektimit, për çdo subjekt inspektimi, gjatë javës.

#### Neni 4

#### Programi vjetor i inspektimeve

1. Programi vjetor përcakton tematikat e inspektimit, që hartohen bazuar në objektivat vjetorë dhe afatmesëm të inspektoratit shtetëror, në zbatim të politikave të përcaktuara nga Ministria e linjës, duke përcaktuar në mënyrë sasiore aktet e inspektimit për sektorët/kategoritë e subjekteve të inspektimit gjatë vitit.
  - \* *Duke qenë se matricat e vlerësimit të riskut nuk janë populluar ende me të dhëna, për të bërë përzgjedhjen e rastësishme të subjekteve të inspektimit në bazë të vlerësimit të riskut që prodhojnë, programimi do të bëhet mbi bazë tematikash dhe kategorish subjektësh të ndara sipas këtyre tematikave.*
2. Programi vjetor i inspektimeve planifikon në mënyrë sasiore aktet e inspektimit duke u bazuar në:
  - a. Numrin e inspektorëve shtetërorë dhe kualifikimet e tyre. Inspektorati shtetëror duhet të përcaktojë qartë orët efektive të punës të inspektimit në vend dhe në zyrë të inspektorëve shtetërorë, duke analizuar orët inefektive për arsye udhëtimi në subjektet e inspektimit, leje të programuara, trajnime, ose veprimtari të tjera të programuara, duke lënë gjithsesi një hapësirë për aktivitete të paprogramuara osë paafësi të përkohshme të mundshme. Orët e punës efektive të çdo inspektori kanë vlerë në varësi të kualifikimeve të tyre, që i bëjnë të aftë për inspektime të subjekteve të caktuara të inspektimit brenda fushës së inspektimit të të njëjtit inspektorat shtetëror.
  - b. Numrin e subjekteve të inspektimit dhe kategoritë e tyre. Subjektet që bien në fushën e inspektimit të një inspektorati shtetëror ndryshojnë në numër, kjo mund të rrisë ose ulë probabilitetin për inspektim. Bazuar në tematikat e programit vjetor dhe kategorizimit të subjekteve të inspektimit, këto ndahen në disa grupe, ku përcaktohen fillimisht kategoritë e subjekteve të cilat kanë detyrimin për t'u inspektuar periodikisht, pra duhet të inspektohen detyrimisht gjatë vitit, më pas në bazë të tematikave të përcaktuara në programin vjetor përcaktohen kategoritë e tjera të inspektimit, duke llogaritur edhe probabilitetin për inspektim për secilën kategori, në bazë të disponueshmërisë së numrit të inspektorëve sipas pikës 1, si dhe në bazë të pikave 3, 4 dhe 5.
  - c. Shpërndarjen territoriale të subjekteve të inspektimit, sipas objektit të inspektimit. Shpërndarja territoriale e subjekteve të inspektimit, ose të vendeve ku ndodhet objekti i inspektimit, është e rëndësishme për të llogaritur kohën inefektive të punës, si dhe është e dobishme për minimizimin e saj, në rastet kur planifikohen më shumë se një akt inspektimi në ditë.
  - ç. Kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e inspektimeve sipas subjekteve. Çdo akt inspektimi, në varësi të objektit të inspektimit dhe subjektit të inspektimit ka një kohëzgjatje të caktuar, që në vazhdimësi duhet të kategorizohet, për të mundësuar një programim sa me efektiv.
  - d. Numrin e personelit mbështetës ose mjeteve të nevojshme për aktin e inspektimit. Aktet e inspektimit kanë nevojë për personal mbështetës ose për mjete mbështetëse,

të cilat nuk janë gjithnjë të disponueshme për të gjithë grupet e inspektimit në të njëjtin moment.

#### **Neni 5**

#### **Programi mujor i inspektimeve**

1. Programi mujor i inspektimeve përcakton subjektet e inspektimit bazuar në programimin vjetor të inspektimeve, ku për çdo muaj përcaktohet në mënyrë sasiore aktet e inspektimeve sipas sektorëve/tematikave.
2. Për çdo kategori subjektsh inspektimi, ose subjektsh inspektimi, fusha e veprimtarisë e të cilëve lidhet me një tematike të programit vjetor, përzgjidhet në mënyrë rastësore një numër i caktuar subjektsh për t'u inspektuar.
3. Numri i subjekteve të përzgjedhura varet nga sasia e akteve të inspektimeve të përcaktuara ose pesha specifike e tematikës në muajin në të cilin behët programimi i subjekteve të inspektimit, sipas programimit paraprak vjetor.

#### **Neni 6**

#### **Programimi javor i inspektimeve**

1. Programimi javor i inspektimeve bazohet mbi programimin mujor të subjekteve të inspektimeve, i cili ka natyrë sasiore dhe cilësore, duke përcaktuar qartë të gjitha elementet e aktit të inspektimit të cilat shërbejnë në përmbajtje të autorizimit, ku në veçanti ato që lidhen me:
  - a. Subjektin e inspektimit;
  - b. Objektin e inspektimit;
  - c. Inspektorët shtetërorë;
  - ç. Persona të tjerë ndihmës;
  - d. Kohëzgjatja;
  - e. Vendi ose vendet ku do të kryhet inspektimi.
2. Përcaktimi i elementeve të aktit të inspektimit sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen në mënyrë të rastësishme, në varësi të disponueshmërisë së inspektorëve shtetërorë, personave të tjerë ndihmës ose mjeteve. Përjashtim bëjnë inspektimet e përbashkëta të kordinuara nga Inspektorati Qendror, ku data dhe ora e inspektimit paracaktohen nga ky i fundit.
3. Programimi javor i inspektimeve duhet të respektojë afatet proceduriale për njoftimin në kohë të autorizimit të aktit të inspektimit bazuar në Ligjin për Inspektimin.

### **KREU III**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 7**

#### **Inspektimet jashtë programit**

Programimi i akteve të inspektimit lejon në masë të caktuar edhe inspektimet jashtë programi, në rastet përjashtimore bazuar në Ligjin për Inspektimin, të cilat duhet të programohen në

mënyrë sasiore në fillim të vitit, me qëllim eliminimin e rasteve të mbivendosjes dhe mbingarkesës së punës.

#### **Neni 9**

#### **Monitorimi i vazhdueshëm i programeve të inspektimit**

Programet e inspektimit monitorohen në vazhdimësi, me qëllim standartizimin e elementeve të programimit vjetor, mujor dhe javor.

#### **Neni 10**

#### **Përcaktimi i nëpunësve përgjegjës**

1. Titullari i inspektoratit shtetëror autorizon nëpunësit përgjegjës për programimin e inspektimeve, të cilët do të kenë akses në portalin “e-Inspektimi”, për gjenerimin e programve vjetore, mujore dhe javore, si dhe ndryshimeve gjatë kohës.
2. Në përmbushjen e detyrës së ngarkuar, nëpunësit përgjegjës sipas pikës 1 të këtij neni, mund të mbështen nga komuniteti shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit.